

VENDIM
Nr. 578, datë 24.6.2015

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 545, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4/2, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 4/13, të vendimit nr. 545, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 4/14 me këtë përmbajtje:

“4/14. Nëpunësit në njësitë e integritit evropian dhe ato të menaxhimit të fondeve IPA në ministrinë e linjës, nëpunësit e ngarkuar me përafrimin e legjislacionit dhe programimin e monitorimit e asistencës së BE-së në Ministrinë e Integritit Evropian, nëpunësit e ngarkuar me hartimin e legjislacionit në ministrinë e linjës, nëpunësit në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë, drejtori i Departamentit të Legjislacionit në Kryeministri, nëpunësit e ngarkuar me hartimin e legjislacionit në njësinë e legjislacionit dhe akteve të Këshillit të Ministrave në Kryeministri, si dhe nëpunësit, të cilët janë të ngarkuar me integrimin dhe hartimin e akteve ligjore e nënligjore (jo më shumë se 3 nëpunës) në Departamentin e Administratës Publike, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë në muaj.

Zbatimi i kësaj shtese për nëpunësit e sipërpërmendur bëhet sipas përshkrimit të pozicionit të punës dhe pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike dhe të drejtorit të Departamentit të Legjislacionit në Kryeministri, për nëpunësit e ngarkuar me hartimin e legjislacionit, dhe të Ministrisë së Integritit Evropian, për nëpunësit në njësitë e integritit evropian dhe të menaxhimit të fondeve IPA në ministrinë e linjës.

Në rast se për nëpunësit e sipërcituar parashikohen në këtë vendim shtesa të tjera për kushte pune, këta nëpunës zgjedhin ndërmjet dy shtesave, por në asnjë rast nuk mund t'i përfitojnë të dyja shtesat.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2015, të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion për vitin 2015.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare duke filluar nga data 1 shtator 2015.

KRYEMINISTRI
Edi Rama